

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

---

### Ikja / *el-Firaar* /

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

“Atëherë, ikni tek Allahu.” (edh-Dhaarijaat, 50)

Ikja tek Allahu është ikje nga ajo që nuk ekziston<sup>1</sup> te ajo që ka ekzistuar gjithmonë. Kjo ka tri nivele:

- Ikja e shumicës së besimtarëve është:
  - a. Ikje nga mosdija në dije, me siguri dhe angazhim të zellshëm
  - b. Ikje nga plogështia në entuziazëm, me vigjilencë dhe vendosmëri
  - c. Ikje nga ngushtësia në gjerësi, me besim dhe shpresë<sup>2</sup>
- Ikja e elitës së besimtarëve është:
  - a. Ikje nga të dëgjuarit në të parët<sup>3</sup>
  - b. Ikje nga imazhet (format) në realitete<sup>4</sup>
  - c. Ikje nga lidhja me të dëshirueshmet në zhveshjen<sup>5</sup> e të dëshirueshmeve

---

<sup>1</sup> Krijesat që patën një fillim para të cilit nuk kanë ekzistuar.

<sup>2</sup> Vetëm bindja për Zotin e për jetën e përtejme si dhe shpresa te kënaqësia e te shpërblimi i më të Lartit do të ta mundësojë të ikësh nga ngushtësia e kësaj bote në gjerësinë e realitetit përfundimtar.

<sup>3</sup> Domethënë, nga *ilm el-jekin* (dija e bazuar në siguri dhe prova) në *ajn el-jekin* (dija e bazuar në ta parët e syve). Mosbesimtarët kërkuan këtë, por nuk kishin pranuar besimin së pari, prandaj nuk morën përgjigje. Ibrahim عليه السلام kërkoi këtë, pasi pranoi besimin dhe e meritonte, prandaj mori përgjigje. Niveli i fundmë i bindjes është *hakk el-jekin* (e vërteta e bindjes), që ka të bëjë me ndjesi. Për shembull, ta shohësh zjarrin është një gjë, kurse t'i ndiesh flakët e tij është diçka tjetër.

<sup>4</sup> Disa imazhe duhet respektuar, siç është forma sunite e namazit (lutjes), mirëpo përulësia (*khushû*) e zemrës dhe ndjenja e lidhjes me Zotin janë thelbi i namazit. Këto, pra, janë realitete të cilave u duhet kushtuar vëmendje.

- Ikja e ajkës (më të mirëve) së elitës së besimtarëve:
  - a. Ikje nga tërë ajo që ekziston krahas të Vërtetit te i Vërteti<sup>6</sup>
  - b. Ikje nga të parët e ikjes vetjake në të parët e të Vërtetit<sup>7</sup>
  - c. Ikje nga ikja (te i Vërteti) te i Vërteti<sup>8</sup>

---

<sup>5</sup> Zhveshja i referohet asaj që mund ta quajmë minimalizëm. Ky minimalizëm s'është i kufizuar në pasjen e pakët të teshave dhe orendive, por shkon përtej kësaj - në një dashje më të pakët të të dëshirueshmeve, si: pasuria, fuqia (pushteti), fama, dallimi, njohja nga të tjerët, pranimi nga të tjerët, etj. Vetëdija jonë e tkurrur për të dëshirueshmet, që garon me kënaqësinë e Zotit në zemrat tona, mund të jetë shkatërruese, sidomos për ata që janë në gjendje t'i kontrollojnë dëshirat e tyre për kënaqësi epshore.

<sup>6</sup> Kjo është atëherë kur asgjë nuk ta heqë vëmendjen nga të kërkuarit e Atij dhe nga udhëtimi për afrim ndaj Tij.

<sup>7</sup> Kjo është atëherë kur ti pushon së pari veprimet e tua, përfshirë këtu dhe ikjen tënde tek Ai, në mënyrë që ta shohësh vetëm Atë.

<sup>8</sup> Kjo është atëherë kur vullneti yt të shpërbëhet në të Tijin dhe të vazhdojë të ekzistojë pranë të Tijit, kështu që s'ka më ikje. Imam Ibn el-Kajjim u zgjerua në këto nivele dhe tha se gjendja më e mirë është ta shohësh ikjen tënde nëpërmjet Allahut (me ndihmën e Tij) nga Allahu (pakënaqësia e Tij) te Allahu (kënaqësia e Tij), si dhe t'i përmbushësh kërkesat e robërimit në çdo pamje.